SPECIFIKIME TEKNIKE

"Permiresimi i KUZ Sarande, Ksamil-ITUN (Baypass dhe vendosje saraqineska manovrimi ajrues)

Para fillimit të punimeve të bëhet verifikimi i kuotave të projektit nga një topograf i liçensuar, në prani të projektuesit, supervizorit dhe një përfaqësuesi të bashkise, ky i fundit, me cilësinë e porositësit të objektit. Në fund të verifikimit të hartohet proçes verbali përkatës.

Për çdo ndryshim, në kuotë, trasim etj. të projektit, të kontaktohet paraprakisht me projektuesin dhe pasi të jepet zgjidhja nga ky i fundit të mbahet një proçes verbal, në prani të supervizorit, projektuesit, zbatuesit, dhe të një përfaqësuesi të komunës.

Duhet pasur parasysh që punimet për rrjetin e K.U.Z., të nisen nga pika 45 dhe do te perfundoj ne piketen 57 te K.U.Z puset Ksamil.

Për punimet e këtij projekti do të zbatohen Kushtet Teknike të Zbatimit të Kanalizimeve të ujrave të zeza, që janë në fuqi (K.T.Z. 26 -81 "Kushte Teknike të Zbatimit dhe Marrjes në dorëzim të Punimeve për Ndërtimin e Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësave dhe Kanalizimeve"), si dhe të zbatohen rreptësisht kushtet e sigurimit teknik të punimeve, sipas standarteve dhe Kushteve Teknike të Sigurimit Teknik në fuqi, qoftë për punimet e çdo lloji në sipërfaqe, ashtu edhe për punimet e çdo lloji të kryera në thellësi të kanalit apo gropave përkatëse gjatë zbatimit të objektit. Punimet do të zbatohen rreptësisht me topograf të licensuar për aftësitë e tij në punime zbatimi, sipas planimetrisë dhe profileve gjatesorë, në prezencë të investitorit dhe supervizorit.
Volumet kryesore të punimeve, jepen në preventivin përkatës bashkangjitur këtij relacioni.

Përpara fillimit të punimeve ne baze te llogaritjeve dhe trasimit te rrjetit ne fazen e projekt zbatimit si dhe per plotesimin e kushteve teknike te projektimit dhe standarteve shteterore per ndertimin e kanalizimeve te ujrave te zeza, do te perdoren materialet si me poshte:

NDERTIMI I K.U.Z

1.-Tubacionet

Ne mbeshtetje te projektit te hartuar per “Permiresim i k.u.z Sarande, Ksamil-i.t.u.p (Baypass dhe vendosje saraqineska manovrimi ajrues)" do te perdoren tubacione HDPE 100 te prodhuara per sisteme ujsjellesash me teper, por edhe per shkarkimet e ujrave te zeza, me diametra si me poshte:

Tub plastik i brinjezuar HDPE 100 PN6, Ø500x19.1mm gjatesi 6 -12m

Perdorimi

Tubat, paisjet, aksesoret duhet te transportohen, magazinohen dhe perdoren ne menyre qe te menjanohen rreziqet. Cengelat nuk duhet te kene kontakt me siperfaqet bashkuese. Tubat plastike duhet te ekspozohen nese eshte e nevojshme per te parandaluar perkuljen nga rritja e nxehtesise. Tubat e demtuar duhet te hiqen nga vendi i punes.

Pastrimi

Pjesa e brendeshme e te gjithe tubave dhe paisjeve duhet pastruar perpara instalimeve dhe duhen rujatur te paster deri sa puna te pranohet. Te gjithe siperfaqet bashkuese te kontaktit duhet te ruhen te pastra deri sa bashkimi te perfundoje.

Duhet te ndalohet futja e materialeve te jashtme ne brendesi te tubave, gjate instalimit. Asnje mbetje, mjet, veshje apo material tjeter nuk duhet te vendosen mbi tuba.

Vendosja e Tubave

Tubacioni duhet te vendoset sipas linjave dhe gradeve te percaktuara nga vizatimet. Zhvendosja e njeaneshme e tubit duhet te shmanget gjate vendosjes. Tubat nuk duhet te vendosen ne uje, as nen kushte te papershtatshme te kohes apo te kanalit.
Vendosja e tubave duhet te filloje ne nivelin me te ulet te rritjes, me mbarimin e sinjalit tregon drejtimin te shtrimit pervec se kur rishtrimi lejohet nga inxhinieri.
Ne cdo moment qe shtrimi ndalon, fundi i hapur i tubit duhet te mbyllet fort duek puthitur fundin e tubit per te mos lejuar hyrjen e reres apo te dheut ne tub. Paneli i fundit duhet te kete disa vrima te vogla afer qendres per te lejuar ujin te hyje ne tub dhe te ndaloje fluksin e madh ne rast permbytjeje te kanalit. Tubat nuk duhet te ekspozohen ne diell pasi jane vendosur ne kanal.

Bashkimi

Te gjithe pregatitjet per bashkim dhe vete bashkimi duhet te realizohen sipas instruksioneve dhe rekomandimeve te prodhuesit te tubit. Menjehere para se bashkimet te jene afruar per tu bashkuar, e gjithe siperfaqja bashkuese duhet te lyhet me lubrifikantin qe eshte dhene bashke me tubin pozicioni dhe kushtet e cdo rubber gasket (gaskets te pakufizuara) duhet te kontrollohet me nje sensor pasi te jete bere bashkimi.

2.-Perkujdesje te ndryshme

Pika e shkarkimit te ujrave te zeza

“Permiresim i k.u.z Sarande, Ksamil-i.t.u.p (Baypass dhe vendosje saraqineska manovrimi ajrues)" Thellesia e germimeve
Ne baze te diamterit te tubacioneve qe do te pedoren, gjeresia e transheve do te jete: 60 cm per diametrat nominale perfshire nga Ø 200 mm dhe Ø 250 mm
150 cm per diametrat nominale Ø 500 mm

Hapja e kanalit

Hapja e kanalit do te varijoje sipas tereneve. Transheja duhet te hapet me pjerresi skarpate m = 0.2 për kanalet e cekëta (h < 2 m) dhe me pjerrësi skarpate m = 0.5 për thellësi më të mëdha. Duhet pasur kujdes që të përdoren edhe transhetë apo palankolat në gërmimet mbi 2.0 m thellësi.

Ne te gjitha rastet, dherat do te vendosen nga njera ane e transhese, me qellim qe te lehtesohet vendosja e tubave.

3.- Shtresa mbrojtese e tubit

Perpara vendosjes te tubave plastik HDPE 100 tabani i kanalit duhet te jete i niveluar. Poshte ketyre tubave plastik do te kete shtrese rere 10 cm, ndersa mbi tubin plastik do te kete: 30 cm rere, për tubin me diameter 500 mm.

Mbi kete shtrese rere hidhet ose zhavorr lumi i seleksionuar 10/20 mm kur tubi kalon në rrugë ose dheu i kanalit i seleksionuar nga guret dhe materialet e tjera te ngurta duke e ngjeshur ate me tokmak druri, kur tubi kalon në vende jashtë rrugës.

4.- Kthimi ne kushte teknike te infrastruktures ekzistuese

Perpara hapjes se kanaleve te behet azhornimi per infrastrukturen ekzistuese si rrjeti i ujesjellesit te lagjes, rrjeti telekomit,elektrikut etj.

Por ndodh qe keto rrjete nuk jane percaktuar saktesisht,keshtu qe del e domosdoshme riparimi i tyre ne rast te ndonje demtimi gjate hapjes se kanaleve primare dhe sekondare.

Punimet per kthimin ne kushte teknike te rrjetit ujesjelles,telekom dhe elektrik do te behen nga sipermarresi nen vezhgimin e drejtuesit te punimeve.

5.-Pusetat e kontrollit

Jane parashikuar puseta me beton (thellësia e pusetës deri në 2 m) dhe beton arme (thellësia e pusetës mbi 2 m) dhe te mbuluara me kapak gize.

Sipermaresi do te ndertoje puseten ne pozicionet dhe dimensionet e treguara ne projektin e Kontrates.

Pusetat do te lejojne hyrje per te bere kontrollin dhe pastrimin e kanaleve dhe jane vendosur ne pika ku ka ndryshim te drejtimeve, ndryshime te madhesise se tubave, ndryshime te pernjehereshme te pjerresise.

Muret e pusetave

Do te ndertohen me beton (thellësia e pusetës deri në 2 m) ose beton arme (thellësia e pusetës mbi 2 m), siç tregohet ne vizatimet .

Gjate ndertimit te pusetes do te fiksohen ne muret e saj shkalle prej hekuri te galvanizuar me gjeresi vertikale dhe horizontale prej 300 mm. Gjithashtu në muret e pusetave që lidhin tubacionet

e shtëpive me rrjetin do të vendosen gjatë punimeve, tubacione plastike në muret e pusetës me thellësinë 1.20 m nga kapaku i pusetës, për të mundësuar lidhjen e tubacioneve të shtëpive pa çarë muret e pusetës. Hapja e vrimave ne mure mbas ndertimit nuk do te lejohet.

Shtresat e bazamentit

Pasi hapet gropa e pusetes, toka duhet te pergatitet ne menyre qe te siguroje themele te pershtateshme. Per kete arsye toka poshte bazamentit te pusetes do te kompaktesohet. N.q.se toka ekzistuese nuk siguron nje bazament te pershtatshem atehere do te perdoret zhavorr dhe/ose beton M.200.

Pjesa e poshteme e pusetes eshte zakonisht prej betoni, me pjerresi drejt nje kanali te hapur qe eshte zgjatje e kanalizimit me te ulet. Ky kanal duhet te jete i percaktuar shume mire dhe me thellesi te mjaftueshme ne menyre qe te parandaloje derdhjet e kanalizimeve te perhapen mbi fundin e pusetes.

Suvatimi

Pjesa e brendeshme e pusetes duhet te suvatohet me suva 1:2 çimento / rere.

Zona perreth pusetes nuk mund te mbushet menjehere pasi puna per mbushjen duhet te behet kur suvaja te jete perfunduar.

Kapaket e pusetave

Kapakët e Rrjetit do te jene kapak prej gize sipas rrugicave dhe kalimit te mjeteve ne to. Kapaket dhe kornizat do te parashikohen sipas hapesires drite te pusetes siç eshte treguar ne vizatime.

Kapaket do te vendosen ne nivelin dhe pjerresine perfundimtare te siperfaqes se rruges, ne rruget e shtruara me makadam dhe 50 mm me lart ne rruget e pashtruara. Ne siperfaqet e hapura dhe fushat kapaku do te jete 500 mm mbi zonen rrethuese.

6.-Mbushja

Pasi te jene hedhur shtresat mbrojtese te tubacionit plastik HDPE 100, mbushja e kanalit do te behet me kujdes me dhe te germimeve te seleksionuar nga guret e medhenj dhe me pas do te behet kthimi i rrugeve ne gjendjen e meparshme me shtresa sipas vizatimeve.

7.-Materialet per ndertimin e tyre duhet te plotesojne kushtet e meposhteme:

7.1.Cimento.

Perveç rasteve qe nuk keshillohet, do te perdoret çimentoja e zakonshme qe gjendet ne tregun shqiptar. Keshillohet te perdoret cimento, me rezistence 42,5.

7.2.Uji.

Uji qe do te perdoret per te gjitha perzierjet do te jete i cilesise se mire, i paster dhe pa lende te tjera te demshme.

Ne te gjitha rastet sasia e ujit qe do te perdoret duhet te regullohet saktesisht ne menyre te atille qe te arrihet te perftohet rezistenca e betonit te pergatitur, duke ditur gjithashtu se kjo pergatitje varet nga cilesia e granilit dhe kushteve klimaterike.

7.3.Rera.

Per pergatitjen e betonit, do te perdoret gjithmone rere lumi e paster, e cilesise se mire. Ajo do te lahet per ti hequr te gjitha pjeset e huaja dhe ato argjilore.

Nuk do te perdoren ne asnje rast mbeturina copash gelqereje, as rere deti. Granulometria e paraqitur eshte ne funksion te perdorimit

- per beton : granulometri 0,1/5,
- per llac : granulometri 0,1/3.

7.4.Granil.

Granili do te perbehet nga materiale natyrore, qe nxirren nga lumi ose nga thyerja. Do te perdoret ekskluzivisht granil i cilesise se mire, kalibruar sipas ketyre te dhenave :

- 10/20 per shtresat e bazamenteve,- 5/10 per betonet.

7.5.Hekuri per beton.

Celiku qe do te perdoret per punimet beton arme do te jete i markes FeB/44-K ose FeB/38-K, konform normave te vendit STASH 858/87, ose te ndonje norme tjeter ekuivalente nderkombetare.

Armaturat duhet te jene te diametrave te dhene sipas planeve teknike, te plota, rrethore, prej çeliku bruto. Armaturat do te jene te tipit Perputhje e Larte, dhe do te perbehen nga hullinj. Ne te gjitha rastet, armaturat do te vajisen me kujdes perpara procedures se derdhjes se betonit, me qellim qe te sigurohet perputhja maksimale.

Hartoi

Firmitas Studio sh.p.k

Ing. Sokol Bala